



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA RAJONALE TIRANË

Nr. 2864 Prot

Tiranë, më 26.5.2026

Lënda: Njoftim për ekzekutim vullnetar të gjobës administrative.

SUBJEKTIT “AL & NO”, NIPT L11325029E

Adresa: Ndërtesë 1 katëshe 50 mentra pranë shinave të trenit, Fushë Mëzezë, Kashar, Tiranë

TIRANË

Në përfundim të procesit të inspektimit të kryer nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tiranë, *ndaj subjektit “AL&NO”, me Nipt M11325029E, është marrë Vendimi Përfundimtar i Inspektimit me Nr.ISHPSHSH-TR-2026-000894-5, datë 17.03.2026, me të cilin është vendosur masa administrative gjobë, në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.*

Pas marrjes dijeni të Vendimit Përfundimtar të Inspektimit, nga ana juaj nuk është ushtruar e drejta e ankimit administrativ pranë **Komisionit të Shqyrtimit të Ankimeve të Inspektoratit të Përgjithshëm**, brenda afateve ligjore.

Në bazë të nenit 34 të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për Inspektimin në Punë”, i ndryshuar, ekzekutimi i gjobave administrative kryhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Gjithashtu, në nenin 15 të Ligjit për Kundërvajtjet Administrative parashikohet se:

“1. Vendimi për kundërvajtjen administrative nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore nëse ligji i posaçëm parashikon të drejtën e subjektit për t'u ankuar në rrugë administrative, por kjo e drejtë nuk është ushtruar. Për ekzekutimin e tij zbatohen dispozitat e kreut V të këtij ligji.”

Nga sa më sipër, ju njoftojmë se **Vendimi Përfundimtar i Inspektimit Nr.ISHPSHSH-TR-2026-000894-5, datë 17.03.2026, në përputhje me nenet 23 dhe 24 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, është shndërruar në titull ekzekutiv dhe duhet të ekzekutohet në mënyrë vullnetare.**

Në dispozitat e Kreut V të ligjit nr. 10279/2010, konkretisht në nenin 30, pika 1, parashikohet se:

“Gjopa dhe shumat që duhet të paguhen sipas vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, paguhen nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data kur është njoftuar për vendimin e dënimit me gjobë, i cili përbën titull ekzekutiv.”

Në këtë kuadër, ju bëjmë me dije se pagesa e gjobës duhet të kryhet **brenda 10 (dhjetë) ditëve**. Bashkëlidhur gjeni **faturën për arkëtimin e gjobës**. Pas kryerjes së pagesës, lutemi të dërgoni **mandatin e arkëtimit** në adresën elektronike: **info@sli.gov.al**.

Në rast të moskryerjes së pagesës brenda afatit ligjor, **Drejtoria Rajonale Tiranë** do të vijoje me ndjekjen e procedurave për **ekzekutimin e detyrueshëm**, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

KRYEINSPEKTORI

Eljo Muçaj

A handwritten signature in blue ink, consisting of stylized, overlapping loops, is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRIE", "RAJONI I TIRANË", and "INSPEKTORIA".

FATURË PËR ARKËTIM

Nr. 107

Datë 25.05.2026

BANKËS _____ Llogaria e te Ardhurave

Me anë të kësaj fature kërkojmë që Banka e Nivelit të Dytë të pranojë nga klientë (persona, persona fizikë, persona juridikë), arkëtime për llogari të institucionit tonë, me emërtime, kode, numer identifikimi dhe shuma si më poshtë

Emri i Institucionit përfitues

ISHPSHSH
Drejtoria Qendrore Tiranë

Kodi i Institucionit Përfitues

1004210

Kodi Degës së Thesarit ku vepron

3535

Emri i paguesit (persona/persona fizik/person juridik)

AI-No.

Numri identifikimit të paguesit

L11325029E

PËRSHKRIMI I TË ARDHURAVE			SHUMA
ID	Emertimi	Kodi Ilog.Ekonomike	ARKETUAR
Detyrimi			Leke
1	NR.ISHPSHSH-TR-2026-000894-5 date 17.03.2026	7115499	100,000
	Njeqind mije leke		
	TOTALI		100,000

INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE

AI-No

DREJTORIA RAJONALE TIRANË

Eljo Muçaj

Shënim: Për Bankat e Nivelit të Dytë

Në zbatim të nenit 30, ligji 10279 datë 25.05.2010 "Për kundravajtjet administrative", fatura për arkëtim është e vlefshme për pagesë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e lëshimit të saj. Në të kundërt anulohet.